

AKT THEMELIMI

SHOQËRISË TREGTARE “MERCATO ITALIA SH.P. K”

ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 19. 01. 2023 (dymijë e njëzet e tre), ortaku themelues:

Dionis Teqja, i biri i Ahmetit, lindur më 25/06/1969, në Peqin, identifikuar me pasaportën nr. BC4972003, banues në Tiranë, në adresën njësia Administrative 5, Rruga Bajram Curri, nr. 1824/013.

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare **MERCATO ITALIA SH.P. K**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **MERCATO ITALIA SH.P. K**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **MERCATO ITALIA**.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Import-eksport, tregtim me pakicë dhe me shumicë i produkteve të industrisë ushqimore dhe i produkteve të kujdesit personal. Prodhim dhe përpunim i produkteve ushqimore. Tregtimin me shumicë të produkteve industrial.

Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, me objektin e mësipërm, të tilla si por pa u kufizuar, aktivitet tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm ne mënyrë qe te realizohet objekti i shoqërisë.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: **Autostrada Tr-Dr, KM7, Kashar, Qendra Tregtare Megatek, Tiranë.**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut themelues, në vlerën 1.000.000 (një milion) lek.

Kapitali themeltar të shoqërisë zotërohet nga ortaku si vijon:

1. Dionis Teqja zotëron 100 % të kapitalit të regjistruar, e cila përbën 1 kuotë në vlerën prej 1.000.000 (një milion) lek.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht nga ortaku themelues. Kontributi në kapital është në para.

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/ortaku i vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.



Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Klodian Naska, i biri i Gjergjit, lindur më 25/10/1976, në Lushnje, mbajtës i pasaportës nr. H61025042A, banues në Tiranë në adresën Rr. "Robet Shvarc", Tiranë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët veç e veç, do të ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi, përveç kompetencave që lidhen me aspektin financiar të shoqërisë të cilat do ushtrohen bashkërisht nga të paktën dy prej administratorëve

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.



NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKU

DIONIS TEQJA

Dionis Teqja
Teqja